| 29 | Vlerësimi vjetor i<br>performancës së punës për<br>secilin pedagog,          | Performanca hartohet<br>në fund të cdo viti<br>akademik dhe<br>nënshkruhet nga<br>pedagogu përkatës dhe<br>drejtuesi i njësisë bazë.<br>Performanca<br>dorëzohet te Zyra e<br>Burimeve Njerëzore<br>UV. | Njësitë<br>Bazë të<br>FSHH                   | Plotësimi I formatit<br>të performancës<br>sipas formatit të<br>UV. | Shtat<br>or<br>2024 | Është Realizuar                                                                                                                          |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**B. Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit**

- b.1. Realizimi objektivave krahasuar me planin strategjik
- b.2. Strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse

Universiteti i Vlorës ka zhvilluar një gamë strategjish për të mbështetur kërkimin shkencor dhe për të promovuar aktivitete kërkimore që përfshijnë të gjithë stafin akademik dhe studentët. Ky angazhim ka për qëllim përfshirjen e stafit dhe studentëve në projekte kërkimore dhe zhvillimin e iniciativave inovative që mund të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve sociale dhe ekonomike të rajonit. Universiteti investon gjithashtu në promovimin e kërkimit shkencor përmes mundësive financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete shkencore ndërkombëtare, duke stimuluar bashkëpunimin me organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe sektorë të tjerë të shoqërisë.

Ky angazhim është i përputhur me misionin dhe vizionin e Universitetit të Vlorës, i cili synon ofrimin e një edukimi dhe kërkimi shkencor të nivelit të lartë, duke kontribuar në zhvillimin e politikave për avancimin ekonomik dhe shoqëror. Përmes përfshirjes aktive të stafit akademik në aktivitete kërkimore ndërkombëtare dhe rritjes së bashkëpunimit mes departamenteve dhe qendrave kërkimore, universiteti krijon një ambient stimulues për zhvillimin e projekteve kërkimore dhe përmirësimin e nivelit të shkencës. Rritja e numrit të projekteve kërkimore konkurruese, botimeve shkencore të indeksuara dhe mbështetja e shkrimit të monografive dhe librave janë pjesë e angazhimeve për të rritur ndikimin dhe përhapjen e kërkimit shkencor të universitetit.

Një prioritet tjetër i rëndësishëm është përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor dhe zhvillimi i aktiviteteve që mbështesin kërkesat praktike të rajonit, duke inkurajuar bashkëpunimin e ngushtë mes studentëve, stafit akademik dhe komunitetit të biznesit. Kjo qasje synon krijimin e mundësive për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat do të ndihmojnë në rritjen e ndikimit të kërkimit shkencor. Përmes këtyre iniciativave, Universiteti i Vlorës synon të kontribuoi në avancimin e kërkimit shkencor global dhe në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë lokale dhe rajonale.

Për një pasqyrë më të detajuar të qëllimeve dhe rezultateve të arritura, referohuni Tabelës nr. 2, e cila ofron informacionet kryesore mbi kërkimin shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit gjatë vitit akademik 2023-2024.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

ii. Fusha Kërkimi Shkencor dhe Veprimtaria Krijuese dhe Inovacioni

**Tabela nr. 2: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit**

| Objektivi 1: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e kërkimit shkencor |                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                           |                                                                                                               |            |         |
|---------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|---------|
| Nr .                                                                            | Plani dhe proceset e planifikuara                                                        | Aktivitetet dhe detyrat konkrete                                                                                                                                                                                                                                                      | Fakulteti / Drejtoria/ Sektori përgjegjës | Realizimi sipas planit strategjik                                                                             | Afati      | Komente |
| 1                                                                               | Hartim projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare                                            | <i>Linja strategjike Nr 1/ Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar, të Planit Strategjik të UV</i>                                                                                                                                                                                      | Fakulteti i Ekonomise                     | Sipas planit strategjik dhe strategjisë së kërkimit shkencor                                                  | 2023-2024  |         |
| 3                                                                               | Integrimi i studenteve në kërkimin shkencor dhe inovacionin                              | Linja strategjike Nr 3: Kërkim shkencor i përbashkët sipas standardeve ndërkombëtare                                                                                                                                                                                                  | Fakulteti i Ekonomise                     | Sipas planit strategjik dhe strategjisë së kërkimit shkencor                                                  | 2023-2024  |         |
| 4                                                                               | Botimin e artikujve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare me bord editorial   | <i>Artikuj me bashkeautore</i> në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial të indeksuara në Pubmed, Scopus etj me seli botimi në vendet e Bashkimit Europian (BE) dhe Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD), por edhe në revista shkencore kombëtare | Fakulteti i Ekonomise                     | Sipas planit strategjik dhe strategjisë së kërkimit shkencor                                                  | 2023-2024  |         |
| 5                                                                               | Pjesëmarrjen në konferenca apo aktivitete të tjera shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare | Stafi akademik i FE është prezantuar me punime në <i>konferenca</i> /aktivitete shkencore (përfshirë dhe ato virtuale) të zhvilluara kryesisht jashtë vendit.                                                                                                                         | Fakulteti i Ekonomise                     | Sipas planit strategjik dhe strategjisë së kërkimit shkencor                                                  | 2023-2024  |         |
| 6                                                                               | Planifikimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik                              | Organizimi është kryer duke harmonizuar ngarkesën për mësimdhënin e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale                                                                                                                                                         | Departamenti                              | Formalizimi nëpërmjet marrëveshjes që lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe | Tetor 2023 |         |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|   |                                                                        |                                                                                                |                                                           | përgjegjësit të departamentit                                                                                                                                                                                                        |             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|---|------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 7 | Realizimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik              |                                                                                                | Departamenti                                              | Dorëzimi i marrëveshjes që lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të departamentit për ngarkesën e realizuar mësimdhënies në normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale | Korrik 2024 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 8 | Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit të studentit | Stafi akademik angazhohet në shpërndarjen e pyetësorit dhe në plotësimin e tij nga cdo student | Pyetësi administrohet nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë UV | Procesi është realizuar me plotësimin e pyetësorit nga studentët në cdo sezon të vitit akademik                                                                                                                                      | Tetor 2023  | Rezultatet e vlerësimit pasqyrohen në performancën vjetore të stafit akademik që hartohet për cdo pedagog nga drejtuesi i departamentit, sipas formatit të miratuar nga Senati Akademik i UV. Performanca hartohet në fund të cdo viti akademik dhe nënshkruhet nga pedagogu përkatës dhe drejtuesi i departamentit. Performanca dorëzohet te Zyra e Burimeve Njerëzore UV. |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                    |                                                                                                                                                                                |                                                                                                             |  |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| 9  | Rishikim dhe dorëzim i syllabusit të lëndëve nga titullari i lëndës. Diskutime dhe me lektorët e lëndës. | Titullarët e lëndëve angazhohen në rishikimin dhe dorëzimin e syllabusit të lëndës para fillimit të vitit akademik. Cdo ndryshim bëhet në përputhje me normativën dhe me justifikime mbështetëse nga titullari.                                                                                                                                    | Departamenti                                       | Dorëzimi i syllabusit në kohë para fillimit të vitit akademik, i nëshkruar nga titullari, lektorët dhe drejtuesi i departamentit                                               | Tetor 2023                                                                                                  |  |
| 10 | Përgatitja e teksteve mësimore që përdoren si literaturë bazë                                            | Pedagogu i lëndës bën kërkesë në departamentin përkatës një sezon para zhvillimit të modulit që do të kërkojë për miratim si literaturë bazë. Së bashku me kërkesën, ku ka shprehur arsyen dhe nevojën për këtë literaturë bazë, dorëzon dhe materialin formatin draft për tu rishikuar dhe vlerësuar nga komisioni i departamentit ku ka aplikuar | Departamenti                                       | Literaturë bazë e miratuar, me standarte dhe e vlerësuar paraprakisht nga komisioni vlerësuar. Literatura e miratuar pasqyrohet në seksionin përkatës të syllabusit të lëndës. | Një semestër për zhvillimin të modulit të përkatës për të cilin kërkohet miratimi i literaturës së detyrues |  |
| 11 | Hartimi i tezave të provimeve të lëndëve nga lektori i lëndës para cdo provimi                           | Hartim në kohe të tezës nga lektori i lëndës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Departamenti                                       | Transparencë dhe barazi për studentët Përmirësim të cilësisë së mësimdhënies                                                                                                   | Para cdo provimi të pjesës apo final                                                                        |  |
| 12 | Erasmus +                                                                                                | Aplikimi i stafit në programet Erasmus në Teaching                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Departamenti + Zyra e marrëdhënive me jashtë në UV | PO                                                                                                                                                                             | 2023 - 2024                                                                                                 |  |
| 13 | Evidentimi i të rejave shkencore në fushën e dixhitalizimit në ekonomi dhe                               | Përfshirja në leksionet e studimeve më të fundit në fushën e dixhitalizimit në fusha të ndryshme të ekonomisë.                                                                                                                                                                                                                                     | Stafi akademik                                     | Po                                                                                                                                                                             | 2023 - 2024                                                                                                 |  |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                                                                                                      |                                                                                                                                                |                                     |                                                                                                               |                                   |                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    | përfshirja e tyre në procesin e mësimdhënies                                                         |                                                                                                                                                |                                     |                                                                                                               |                                   |                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 14 | Këshillimi i studentëve                                                                              | Këshilltari akademik realizon takime të herë pas hershme me studentët e viteve të ndryshme për ti orientuar në funksion të kërkimit shkencor   | Këshilltari akademik/s taf akademik | Po                                                                                                            | 2023-2024                         | Emërohet në fillim të vitit akademik                                                                                                                                                                                                               |
| 15 | Projekte kërkimore shkencore në nivel departamenti                                                   | Koordinimi dhe implementimi i projekteve kërkimore shkencore në nivel departamenti                                                             | Departamenti                        | Realizim i projekteve zbatuese duke vënë në funksionim strukturat kërkimore të Departamentit me partner lokal | Mbyllje e projekteve, Nentor 2024 | Pritet diseminimi i rezultateve të projekteve nëpërmjet prezantimeve në konferenca dhe botimeve në Buletinin e Universitetit të Vlorës.                                                                                                            |
| 16 | Rritje e pjesëmarrjes së stafit akademik dhe kërkimor në projekte zhvillimi dhe ngritje kapacitetesh | Përfshirje në grupë pune të ndryshme të projekteve me impakt institucional, kombëtar dhe ndërkombëtar                                          | Departamenti                        | Pjesëmarrje aktive e anëtarëve të Departamenteve në thirrje të ndryshme.                                      | 2024 - 2025                       | Nga këto anëtarësime, stafi pjesëmarrës ka kontribuar në projekte të ndryshme kërkimore në kuadër të thirrjes dhe ka qënë pjesë aktive a trajnimeve të realizuara me impakt në rritjen e aftësive, njohurive dhe kapaciteteve në fushat përkatëse. |
| 17 | Planifikimi ne Projekt buxhetin e vitit 2024 te aktiviteteteve shkencore                             | Ne fund te vitit është përgatitur projekt buxheti i vitit 2024 në të cilin janë përfshirë të gjitha nevojat e stafit për mbështetje financiare | Departamenti dhe Zyra e financës    | Po                                                                                                            | Nentor 2023                       |                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 18 | Bashkëveprimi i stafit akademik midis anëtarëve të departamentit dhe jashtë tij                      | Përfshirja në grupe studimi brenda dhe jashtë departamentit                                                                                    |                                     | Po                                                                                                            | 2023-2024                         | -                                                                                                                                                                                                                                                  |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                                                                                                      |                                                                                                                             |                                                                     |                                                                                 |            |                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 19 | Rritje e pjesëmarrjes së stafit akademik dhe kërkimor në projekte zhvillimi dhe ngritje kapacitetesh | Përfshirje në grupë pune të ndryshme të projekteve me impakt institucional, kombëtar dhe ndërkombëtar                       | Qendra Kërkimore Shkencore për FE                                   | Pjesëmarrje aktive e anëtarëve të qendrës                                       | 2024       | Nga këto anëtarësime, stafi pjesëmarrës ka kontribuar në projekte të ndryshme kërkimore në kuadër të thirrjes dhe ka qënë pjesë aktive a trajnimeve të realizuara me impakt në rritjen e aftësive, njohurive dhe kapaciteteve në fushat përkatëse. |
| 20 | Planifikimi dhe realizimi i konferencave shkencore nga Njësitë Bazë                                  | Realizimi i dy konferencave shkencore ndërkombëtare nga Departamentet e Gjuhëve të Huaja dhe Departamenti i Gjuhë-Letërsisë | FSHH Departamenti i Gjuhëve të Huaja Departamenti i Gjuhë-Letërsisë | Ndarja dhe promovimi i rezultateve të kërkimit shkencor                         | 2023-2024  |                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 21 | Planifikimi i kërkimit shkencor në ngarkesën vjetore të punës për çdo pedagog                        | Planifikimi i ngarkesës nëpërmjet evidencave të plotësuar                                                                   | Stafi akademik i Njësisë bazë të FSHH                               | Planifikimi i kërkimit shkencor                                                 | Tetor 2023 | Realizuar                                                                                                                                                                                                                                          |
| 22 | Botime të artikujve shkencorë në revista shkencore të indeksuara dhe bord editorial                  | Stafi akademik boton artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare dhe kombëtare                                               | Stafi akademik i Njësisë bazë të FSHH                               | Rritja e kërkimit shkencor në UV                                                | 2023-2024  | Realizuar                                                                                                                                                                                                                                          |
| 23 | Pjesëmarrje dhe prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare                       | Stafi akademik përfshihet në pjesëmarrje dhe prezantime të kontributeve shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare               | Stafi akademik i Njësisë bazë të FSHH                               | Promovimi, ndarja e kontributeve shkencore dhe rritja e kërkimit shkencor në UV | 2023-2024  | Realizuar                                                                                                                                                                                                                                          |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                                                                                     |                                                                                                                                                                                            |                                       |                                                      |              |                                                                                                                                                         |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|------------------------------------------------------|--------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 24 | Planifikimi ne projekt buxhetin e Njësive Bazë të FSHH të aktiviteteteve shkencore. | Planifikimi i projekt buxheteve të Njësive Bazë                                                                                                                                            | Njësive bazë të FSHH<br>Dekanati FSHH | Kërkimi shkencor është i planifikuar dhe buxhetuar   | Dhjetor 2023 | Realizuar                                                                                                                                               |
| 25 | Përfshirja e stafit në aplikimet e projekteve AKSH                                  | Zbatimi i projekteve te fituara                                                                                                                                                            | FSHH                                  | Rritja e kërkimit shkencor                           | 2023-2024    | 1 Projekt i realizuar nga Departamenti i Edukimit                                                                                                       |
| 26 | Përfshirja e studenteve në grupet e punës për realizimin e projekteve dhe studimeve | 2 studentë të Departamentit të Edukimit kanë qenë pjesë e grupit të punës në zbatim të një projekti të financuar nga AKKSH dhe 50 studentë të DE janë përfshirë në trajnimet e realizuara. | Njësitet Bazë të FSHH                 | Angazhimi i studentëve në fushën e kërkimit shkencor | 2023-2024    | 1 Projekt i realizuar nga Departamenti i Edukimit "Studimi i ndikimit të Edukimit muzikor në Pedagogjinë e specializuar-Një qasje kërkimore e aplikuar" |
| 27 | Aktiviteti shkencor i Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike          | Botim librash<br>Ëorkshope promovuese<br>Tryeza shkencore dhe kulturore<br>Aktivitet shkencor                                                                                              | FSHH<br>QSAB                          | Rritja dhe promovimi i kërkimit shkencor në FSHH     | 2023-2024    | 3 botime librash<br>7 Promovime të rezultateve shkencore<br>11 aktivitete shkencore (botim artikujsh, tryeza shkencore)                                 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**C. Te dhëna të përgjithshme në lidhje me raportet e vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.**

*Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve*

NJSBCVI është struktura përgjegjëse në nivel institucioni për zbatimin e politikës së SBC-së. Ajo implementon instrumente të ndryshme të miratuar për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative.

Instrumentat e vlerësimit të përdorur prej (NJSBCVI-së) gjatë vitit akademik 2023-2024 janë:

*Pyetësi i Vlerësimit të Cilësisë së Mësimdhënies:*

Pyetësi për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në Universitetin e Vlorës realizohet në fund të çdo semestri dhe ka për qëllim mbledhjen e reagimeve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programeve akademike. Ky instrument i mundëson universitetit të përmirësojë kurrikulat, të zhvillojë profesionalisht stafin dhe të marrë vendime të bazuara në të dhëna konkrete, duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit.

Përdorimi i këtij pyetësi mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, i cili kërkon që institucionet e arsimit të lartë të krijojnë mekanizma të brendshëm për sigurimin e cilësisë dhe përfshirjen e studentëve në vendimmarrje. Realizimi i pyetësit në fund të semestrit siguron që studentët të kenë një përvojë të plotë të kursit, duke dhënë vlerësime të mirëinformuara që kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.

*Statistikat për vitin akademik 2023-2024:*

Cikli i Parë: 26 programe Bachelor të vlerësuara.

Cikli i Dytë: 29 programe MP dhe MS të vlerësuara.

Programi i Integruar në Drejtësi: 1 program DIND.

Programet Profesionale dyvjeçare: 3 programe

Një raport i detajuar mbi rezultatet e analizës së të dhënave publikohet përmes Raportit të hartuar nga NJSVCI në fund të çdo viti akademik. Ky proces vlerësimi është thelbësor për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies në UV.

*Pyetësi për Vlerësimin e Shërbimeve Ndihmëse Akademike dhe Administrative*

Qëllimi i pyetësit për vlerësimin e shërbimeve ndihmëse akademike dhe administrative është të mbledhë reagime nga studentët mbi cilësinë e këtyre shërbimeve, për të identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim dhe për të rritur efektivitetin e tyre. Ky instrument ndihmon në përmirësimin e përvojës së studentëve duke bërë shërbimet më të përshtatshme dhe të aksesueshme, ndërsa gjithashtu siguron transparencë dhe përfshirje të studentëve në proceset e përmirësimit institucional. Në përmbledhje, ky pyetësor synon të mbledhë të dhëna për të mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndihmëse akademike dhe administrative, duke e bërë universitetin një vend më efikas dhe të orientuar drejt nevojave të studentëve.

*Statistika për vitin akademik 2023-2024:*

Pjesëmarrja: 492 studentë të të gjitha cikleve të studimit morën pjesë në pyetësor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Cikli i Parë: Nga 3268 studentë të regjistruar, pyetësi është plotësuar nga 7.34% e tyre, duke përfshirë studentët që ndjekin programin e Diplomës së Integruar në Drejtësi dhe Diplomë Profesionale.

Ciklet e Dytë dhe të Tretë: Pjesëmarrja në këto cikle është 26.33%.

Në total, 11.64% e studentëve të regjistruar në UV për vitin akademik 2023-2024 kanë plotësuar pyetësorët për vlerësimin e shërbimeve ndihmëse akademike dhe administrative.

Në përfundim të analizës së të dhënave, NJSVCI do të hartojë një raport me gjetjet dhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e aspekteve ku ka nevojë. Ky raport do të përfshijë gjithashtu ndarjen e praktikave të mira, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve akademike dhe administrative në universitet.

### Fokus Grupe me studentë.

Universiteti i Vlorës (UV) implementon fokus grupet si një instrument vlerësimi për të mbledhur informacione të thelluara dhe për të kuptuar më mirë përvojat dhe nevojat e studentëve dhe stafit. Ky instrument i lejon UV-së të marrë reagime të drejtpërdrejta mbi cilësinë e programeve të studimit dhe mësimdhënies, duke zbuluar perceptime dhe shqetësime që mund të mos shfaqen përmes pyetësorëve të strukturuar. Duke krijuar një platformë për diskutim të hapur, UV synon të përmirësojë efektivitetin e programeve akademike dhe të sigurojë që ato të jenë në përputhje me pritshmëritë e studentëve dhe standardet e arsimit të lartë. Implementimi i fokus grupeve gjithashtu ndihmon në rritjen e transparencës dhe përfshirjes së komunitetit akademik në proceset vendimmarrëse.

Gjatë muajve Mars – Prill 2024, janë organizuar 11 takime me studentë të programeve Master dhe Bachelor, si dhe të diplomave profesionale. Këto takime ndihmojnë në identifikimin e arritjeve dhe dobësive, si dhe në hartimin e planeve të masave për përmirësimin e vazhdueshëm.

### Objektivat kryesore të organizimit të fokus-grupeve me student përfshijnë:

*Përmirësimi i cilësisë së programeve akademike:* Të mbledhë informacione të detajuara nga studentët për të përmirësuar strukturën, përmbajtjen dhe metodologjinë e programeve të studimit, duke u siguruar që ato përputhen me nevojat dhe pritshmëritë e studentëve.

*Rritja e cilësisë së mësimdhënies:* Të identifikojë praktika të suksesshme dhe sfida në procesin e mësimdhënies, për të zhvilluar strategji që nxisin përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

*Përfshirja aktive e studentëve në proceset vendimmarrëse:* Të sigurojë që zëri i studentëve të dëgjohet në proceset e planifikimit dhe zhvillimit akademik, duke e bërë përvojën studentore më gjithëpërfshirëse dhe të fokusuar te nevojat e tyre.

*Krijimi i një kulture bashkëpunimi:* Të nxisë një kulturë komunikimi të hapur dhe bashkëpunimi midis studentëve, stafit akademik dhe administrativ, duke kontribuar në zhvillimin e një mjedisi akademik më të angazhuar dhe mbështetës.

*Monitorimi i përvojës së studentëve:* Të sigurojë që UV është në hap me ndryshimet dhe trendet në përvojat e studentëve, duke përdorur reagimet e tyre për të përmirësuar shërbimet akademike dhe administrative.

*Përmirësimi i mbështetjes akademike dhe administrative:* Të zbulojë nevojat për përmirësime në shërbimet ndihmëse që u ofrohen studentëve, si këshillimi akademik, mbështetja teknike dhe administrative, duke i bërë ato më efektive dhe të qasshme.

### Takimet e Fokus-Grupit

Gjatë muajit mars, janë organizuar **9 takime fokus-grupe** me studentë në prag diplomimi për programet e mëposhtme:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

1. MS në "Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve Turistike dhe Kulturore"
2. Bachelor në "Financë"
3. Bachelor në "Kontabilitet"
4. Bachelor në "Marketing"
5. Bachelor në "Administrim Biznesi"
6. Bachelor në "Menaxhim Turizmi"
7. Bachelor në "Histori-Gjeografi"
8. Bachelor në "Media në Komunikim dhe Trashëgimi Kulturore" (profili "Gazetari dhe Multimedia" dhe "Trashëgimi Kulturore")
9. Diplomë Profesionale në "Udhërrëfyes Turistik për Rajonin e Jugut"
10. Në muajin prill, janë organizuar 2 takime fokus-grupe:
11. Diplomë Profesionale "Teknik Laboratori Kimik"
12. Diplomë Profesionale "Akuakulturë dhe Higjenë e Produkteve të Peshkimit"

Në përfundim të organizimit të fokus-grupeve, NJSBCV ka përcjellë gjetjet dhe rekomandimet të njësitë përkatëse përgjegjëse për programet e studimit me qëllim të përmirësimit të cilësisë akademike dhe përvojës studentore.

*Pyetësori vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet Alumni-t.*

Qëllimi kryesor i Universitetit të Vlorës (UV) për organizimin e pyetësorit për alumni, përveç instrumenteve të tjerë të vlerësimit, është të mbledhë informacione të detajuara mbi cilësinë e programeve të studimit dhe ndikimin e tyre në zhvillimin profesional të studentëve të diplomuar. Ky proces vlerësimi synon të identifikojë forcën dhe dobësitë e ofertave akademike, duke kontribuar në përmirësimin e strategjive mësimore dhe në përshtatjen e programeve me nevojat e tregut të punës. Kjo iniciativë është e rëndësishme për rritjen e cilësisë së arsimit, angazhimin e alumni në jetën akademike dhe krijimin e një mjedisi që përputhet me kërkesat e shoqërisë dhe zhvillimet e reja në fushën e arsimit të lartë. Përmes këtij instrumenti, UV synon të sigurojë që oferta akademike të mbetet relevante dhe efektive, duke përmirësuar në këtë mënyrë përvojën studentore dhe suksesin profesional të alumni-t.

Në mbështetje të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, si dhe duke u bazuar në Vendimin Nr. 20, dt. 24.04.2023 të Senatit Akademik, "Mbi miratimin e procedurës së analizës dhe vlerësimit të pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet Alumni-t", pika 1, faza e parë, "Plotësimi i pyetësorit prej Alumni-t periodikisht 1 herë në 3 vjet, kohëzgjatja tetor-nëntor", UV ka nisur të aplikojgjtate vititi akademik 23-24 këtë instrument të ri për të mbledhur të dhëna nga të diplomuarit tanë, me qëllimin për të analizuar këto të dhëna dhe për të nxjerrë rekomandime të vlefshme për përmirësimin e programeve akademike dhe për të kuptuar më mirë nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Duke marrë parasysh numrin e studentëve të diplomuar në 3 (tri) vitet e fundit si dhe numrin e studentëve që morrën pjesë në pyetësor (njëzet e tre studentë Alumni), NNJSBCVI e kishte pamundur realizimin e një analize të besueshme dhe përgatitjen e rekomandimeve të sakta dhe të dobishme. Pa një mostër të mjaftueshme të përgjigjeve, çdo analizë që mund të kryejmë do të ishte statistikisht e pasaktë dhe do të mungonte përfaqësimi i drejtë i mendimeve dhe përvojave të të gjithë të diplomuarve tanë. Për të kapërcyer këtë situatë, NNJSBCVI ka propozuar disa masa për nxitjen e ALUMNI në angazhimin e tyre në këtë instrument, dhe shpresojmë që gjatë vitit akademik 2024-2025 të kemi një rritje të numrit të studentëve pjesëmarrës në këtë analizë.

*Workshope:*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

Gjatë vitit akademik janë organizuar workshop-e për stafin akademik, të cilat janë fokusuar në metodat e reja të mësimdhënies dhe strategjitë për angazhimin e studentëve.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IALja, të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.**

Universiteti i Vlorës "Ismael Qemali" gjatë vitit akademik 2023 – 2024 ka krijuar bashkëpunime ndërkombëtare të reja, si dhe ka zgjeruar fushat e veprimit me ato ekzistuese.

UV, nëpërmjet koordinimit të drejtuesve të departamenteve dhe sektorit të projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, ka ndjekur procesin e vlerësimit dhe konkretizimit të shprehjeve të interesit prej universiteteve të reja dhe partnerëve aktualë të huaj sipas rastit.

Bisedimet mbi marrëveshjet e reja apo dhe rinovimi i atyre aktuale kanë ndikuar në përmirësimin e vazhduar të performancës ndërkombëtare të Universitetit të Vlorës duke fituar dhe ide të reja për zgjidhje të problematikave që hasen gjatë procesit të ndërkombëtarizimit në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Në vijim prezantohet informacioni mbi bashkëpunimet ndërkombëtare të nënshkruara përgjatë vitit akademik 2023-2024, të cilat do të kontribuojnë në fusha të ndryshme të zhvillimit të ndërkombëtarizimit të UV-së.

**Tabela nr. 3: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e Kërkimit shkencor dhe Inovacionit**

| Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional |                                              |                                                    |                                                                                    |                                    |                                      |                                                                                         |                                                                                                  |
|-------------------------------------|----------------------------------------------|----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nr                                  | Institucioni Bashkëpunues                    | Lloji i Bashkëpunimit (projekt/bashkëpunim tjetër) | Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit (marrëveshje, ose të tjera) | Data e nënshkrimit të marrëveshjes | Fusha e bashkëpunimit                | Detyrat e palëve dhe produktet (të përmblodhura)                                        | Rezultatet/ Përfitimet (në Vlerë)                                                                |
| 1                                   | University of Naples Federico II (Itali)     | Shkëmbim student/staf                              | Marrëveshje ndërinstitucionale                                                     | 20.09.2024                         | -Shkenca politike<br>-Gjuhët e Huaja | Bashkëpunim për shkëmbimin e studentëve dhe/ose stafit në kuadër të programit Erasmus+. | Granti:<br>-Student 850 €/muaj<br>-Staf 160 €/ditë<br>-Shpenzime udhëtimi në varësi të distancës |
| 2                                   | Catholic University in Ruzomberok (Sllovaki) | Shkëmbim student/staf                              | Marrëveshje ndërinstitucionale e rinovuar                                          | 19.09.2024                         | Gjuhë të huaja (Italisht, Anglisht)  | Bashkëpunim për shkëmbim stafit në kuadër të programit Erasmus+.                        | Granti:<br>-Student 850 €/muaj<br>-Staf 140 €/ditë                                               |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|   |                                             |                          |                                                 |            |                                                                                                                                       |                                                                                                              |                                                                                                                 |
|---|---------------------------------------------|--------------------------|-------------------------------------------------|------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|   |                                             |                          |                                                 |            |                                                                                                                                       |                                                                                                              | -Shpenzime<br>udhëtimi në<br>varësi të<br>distancës                                                             |
| 3 | University<br>of Calabria<br>(Itali)        | Shkëmbim<br>student/staf | Marrëveshje<br>ndërinstitucionale               | 19.09.2024 | -Teknologjitë<br>e<br>Informacionit<br>dhe<br>Komunikimit<br>- Kimi<br>- Matematikë<br>- Fizikë<br>-Financa,<br>banka dhe<br>sigurime | Bashkëpunim<br>për<br>shkëmbimin e<br>studentëve<br>dhe/ose stafit<br>në kuadër të<br>programit<br>Erasmus+. | Granti:<br>-Student 850<br>€/muaj<br>-Staf 160<br>€/ditë<br>-Shpenzime<br>udhëtimi në<br>varësi të<br>distancës |
|                                                                                                                                                                                                                                                                              |  |  |                                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| Universiteti i Teknik i Athinës;<br>Universiteti i Teknik i Hamburgut;<br>ITS<br>Logistica Puglia;<br>Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës;<br>Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Malit të Zi;<br>Drejtoria e Përgjithshme e Detare;<br>Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit. |  |  | Perëndimor në përgatitje për shoqërinë e transportit detar dhe logjistikës me zero karbon. (Zero C) | Shqipëri dhe Mal të Zi (BP) për ofrimin e burimeve njerëzore kompetente, të orientuara nga industria, për industrinë e anijeve në lidhje me dekarbonizimin, efikasitetin e energjisë dhe optimizimin e logjistikës, si dhe për institucionet qeveritare që lidhen me zbatimin e Politikave të IMO dhe BE në sektorin e transportit detar.<br>Rritja e kapaciteteve të IAL-ve të BP (Detare).<br>-Ofrimin e pajisjeve moderne për mbështetjen e kurseve të orientuara drejt aftësive të industrisë për studentët dhe LLL për profesionistët, njohuritë si transferohet tek stafi i IAL-ve të BP në tema specifike, |  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |               |                                |            |                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                              |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------------------------------|------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |               |                                |            |                                                                                  | krijimi i një rrjeti rajonal të palëve të interesuara në sektorin e transportit detar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                              |
| 61 | Univerzitet Adriatik Bar - Adriatic University Bar Javna Ustanova Univerzitet U Tuzli Universitas Studiorum Tuzlaensis Univerzitet Bijeljina Univerzitet U Istocnom Sarajevu Universitetit Te Vlores Universiteti Fan S Noli Korce Necmettin Erbakan Universitesi Visoka Skola Strukovnih Studija Za Vaspitace I Poslovne Informaticar e Mitrovica - Preschool Teacher Training And | Erasmus+ CBHE | Marrëveshje në kuadër projekti | 01.12.2023 | Vjelja (dixhitale), alternimi në mënyra që rrëzojnë paaksesueshmëri në (HAWKING) | HAWKING kapërcen ndarjen dixhitale duke vënë përpara ofrimin e aksesueshmëri së elektronike, përmirësimet dixhitale dhe optimizimet ekzistuese dhe krijimin e strukturave dhe shërbimeve të reja mbështetëse në nivel universitar dhe modernizimin e metodave dhe mjeteve të mësimdhënies dhe të nxënësve që mbështesin nevojat e studentëve të ndryshëm në mjedisin dixhital. Projekti krijon mekanizma të ndryshëm që mbështesin kalimin e drejtë dixhital nga arsimit i | Granti për UV-në nga projekti është 68627 €. |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |               |                                |            |                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                              |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------------------------------|------------|---------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|
|    | Business Informatics College Of Applied Studies, Sremska Mitrovica<br>Eastern Balkans Institute Udruzenja Amputiraca Udas<br>Pedagoski Centar Crne Gore - Pedagogical Center of Montenegro<br>Edex - Educational Excellence Corporation Limited - Univerza V Mariboru<br>Universidad e Da Madeira |               |                                |            |                                             | mesëm në atë të lartë dhe përmirësojnë mjedisin institucional dhe infrastrukturor në IAL-të partnere dhe përmirësojnë metodologjinë e mësimdhënies, në një mënyrë që do të kapërcejë boshllëqet e dixhitalizimit në arsim dhe ofrimin e mbështetjes për studentët. Për të mundësuar ndikim gjithëpërfshirës, HAWKING synon përfshirjen aktive të menaxherëve arsimorë, stafit mësimor dhe jo-mësimdhënës, studentëve dhe prindërve. |                                              |
| 63 | -Universiteti European i Tiranës, Shqipëri.<br>-Kolegji Profesional, Tiranë, Shqipëri.                                                                                                                                                                                                            | Erasmus+ CBHE | Marrëveshje në kuadër projekti | 01.12.2023 | Njohja e Lëvizshmërisë për Integrim (MORIN) | Me fokus njohjen akademike të mobilitetit të studentëve bazuar në rezultatet e të nxënës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Granti për UV-në nga projekti është 70399 €. |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|  |                                                                                                                                                                                                                              |  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |  |
|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  | <p>-Kolegji AAB, Kosovë.</p> <p>-Kolegji "Biznesi", Kosovë.</p> <p>-Universiteti Palaki Olomouk, Republika Çeke.</p> <p>-Universiteti "Shën Kliment Ohridski", Maqedonia e Veriut.</p> <p>-Universiteti i Nishit, Serbi.</p> |  |  |  | <p>MORIN synon të ofrojë një qasje novatore pedagogjike që siguron transparencën e kurrikulës, krahasueshmërinë dhe fleksibilitetin për të përmirësuar procedurat e njohjes dhe transferimit të studimit, si dhe të rishikojë përmbajtjen, metodologjitë dhe vlerësimet lëndore për të siguruar të nxënit me në qendër studentin dhe të orientuar drejt aftësive. Projekti synon t'i shtojë kurrikulës një dimension ndërkombëtar, global, duke rritur kështu bashkëpunimin midis IAL-ve të BP6 për shkëmbimin e studentëve dhe afrimin e tyre me tregun rajonal të punës.</p> <p>MORIN synon zhvillimin e një qasjeje të</p> |  |
|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|  |  |  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |  |
|--|--|--|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|  |  |  |  |  | përbashkët<br>rajonale për<br>njohjen<br>akademike,<br>ndërkombëtare<br>zimin e<br>kurrikulës<br>përmes<br>rezultateve<br>globale të të<br>nxënit,<br>krijimin e<br>procedurave<br>institucionale<br>për njohjen e<br>krediteve<br>përmes<br>miratimit të një<br>modeli bazuar<br>në rezultatet e<br>të nxënit. |  |
|--|--|--|--|--|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:**

**i) Politikat e kërkimit shkencor.**

Ky informacion paraqitet në mënyrë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

- Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor.
- Objektivat dhe synimet bazuar në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor.
- Të dhëna mbi projektet e kërkimit shkencor, në të cilat Universiteti ka aplikuar sipas tabelës.

Universiteti i Vlorës (UV) është angazhuar në zhvillimin dhe fuqizimin e kërkimit shkencor si një komponent kyç i misionit të tij akademik. Politikat e ndjekura nga universiteti synojnë të harmonizojnë qasjet lokale me ato kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në avancimin e njohurive shkencore dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Universiteti i Vlorës ka ndërmarë politika të qarta për të nxitur dhe mbështetur kërkimin shkencor. Disa nga prioritetet kryesore janë:

*Përfshirja e stafit akademik në aktivitete shkencore ndërkombëtare:* UV mbështet financiarisht pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe workshope ndërkombëtare. Kjo ndihmon në promovimin e universitetit dhe në forcimin e rrjetëve bashkëpunuese për projekte të ardhshme.

*Rritja e numrit të botimeve shkencore me ndikim:* Universiteti nxit botimin e artikujve në revista të indeksuara si Thomson Reuters dhe Scopus, duke kontribuar në avancimin e shkencës dhe rritjen e njohjes së punës së stafit akademik.

*Bashkëpunimi i qendrave kërkimore:* Qendrat kërkimore në nivel fakulteti bashkëpunojnë ngushtë me departamentet përkatëse, duke nxitur kërkimet në grup dhe zhvillimin e projekteve të orientuara drejt sfidave bashkëkohore.

*Përforsimi i rolit të studentëve në kërkim:* Universiteti promovon pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe konferenca.

*Mbështetja e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare:* Universiteti inkurajon dhe mbështet hartimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian dhe organizata të tjera ndërkombëtare, duke përmirësuar kapacitetet kërkimore dhe teknologjike.

Universiteti i Vlorës ka përmblodhur objektivat e tij strategjike në disa linja kryesore:

*Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien:* Integrimi i rezultateve kërkimore në kurrikulat akademike për të avancuar cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen e studentëve.

*Promovimi i etikës shkencore dhe integritetit akademik:* Zbatimi i standardeve ndërkombëtare për etikën dhe transparencën në kërkim.

*Harmonizimi i qasjeve lokale me ato globale:* Përmeshja e nevojave të komunitetit duke përvetësuar praktikën më të mira ndërkombëtare.

*Krijimi i partneriteteve të qëndrueshme:* Zhvillimi i bashkëpunimeve me universitete dhe organizata të njohura për projekte kërkimore dhe shkëmbime akademike.

*Përpunimi i njohurive të thelluara shkencore:* Inkurajimi i stafit dhe studentëve për të kontribuar në avancimin e shkencës dhe teknologjisë.

Përmes këtyre politikave dhe strategjive, Universiteti i Vlorës synon të jetë një aktor kryesor në zhvillimin e kërkimit shkencor në Shqipëri dhe të kontribuojë në avancimin e njohurive shkencore në nivel ndërkombëtar. Ky angazhim reflekton vizionin e universitetit për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme dhe inovative në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**Tabela nr. 4: Mbi Projektet e kërkimit shkencor në të cilat IAL ka aplikuar për financim**

| Projekte të aplikuara për financim |                                                                                                                                                                 |         |                                                  |                                                                                                                                                                                                                                          |                                       |
|------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|
| Nr                                 | Emër<br>(Koordinator)                                                                                                                                           | Mbiemër | Fakulteti<br>Ekonomisë                           | Titulli i Projektit                                                                                                                                                                                                                      | Intitucioni<br>Financues/Bashkëpunues |
| 1                                  | Departamenti i Financës<br>dhe Kontabilitetit                                                                                                                   |         | Departamenti i<br>Financës dhe<br>Kontabilitetit | Studim tregu mbi<br>llojshmërinë e<br>shërbimeve<br>financiare dhe<br>kontabël që u<br>nevojiten njësive<br>ekonomike<br>në kushtet e<br>fiskalizimit dhe<br>ndryshimeve të<br>legjislativitetit<br>Studimi përfshin<br>Rajonin e Jugut. | AKSHI                                 |
| 2                                  | Xhiljola Agaraj (Shehu)<br>Filloreta Madani,<br>Lorena Cakerri,<br>Entela Islamaj,<br>Enida Pulaj, Ilirjan<br>lipi, Sonila Berdo,<br>Klaudja Guga, Ilira Pulaj. |         | Departamenti i<br>Financës dhe<br>Kontabilitetit | ADRIAMOVE                                                                                                                                                                                                                                | BE                                    |
| 3                                  | Xhiliola Agaraj (Shehu)<br>Filloreta Madani, Migena<br>Petanaj,<br>Enida Pulaj,<br>Sonila Berdo,<br>Klaudja Guga.                                               |         | Departamenti i<br>Financës dhe<br>Kontabilitetit | Aplikim në kuadër<br>të thirrje Interreg<br>IPA South Adriatic<br>2021-2027 me<br>projekt propozimin<br>me titull<br>"Italy_Albania<br>_Montenegro<br>Community Based<br>Tourism" akronim<br>"IAMCBT"                                    | BE                                    |
| 4                                  | Florian Miti                                                                                                                                                    |         | Departamenti i<br>Ekonomisë                      | Strategjia e<br>Biznesit të<br>Universitetit<br>"Ismail Qemali"                                                                                                                                                                          | UV                                    |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                                                                                                                                                                  |                         |                                                                                                                                                                       |                     |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| 5  | F.Vela<br>E.Pulaj<br>A.Demiri<br>D.Feimi<br>R.Brokaj<br>A. Qarri                                                                                                 | Departamenti i Biznesit | SMART Project                                                                                                                                                         | European Commission |
| 6  | F.Vela<br>E.Pulaj<br>D.Feimi                                                                                                                                     | Departamenti i Biznesit | ILOFORDIGITAL                                                                                                                                                         | BE                  |
| 7  | Rezarta Hasanaj                                                                                                                                                  | Departamenti i Biznesit | STARTUP10                                                                                                                                                             | CIHEAM-Bari         |
| 8  | Agaraj<br>Xhiliola (Shehu)EntelaIslamaj,<br>EnidaPulaj,<br>Ilirjan Lipi,<br>Sonila Berdo,<br>Klaudja Guga,<br>Ilira Pulaj,<br>FilloretaMadani,<br>LorenaCakerri. | Departamenti i Biznesit | Projekt'Active DevelopmentofsustainableMobility Solutions for Enhanced Electric Transport in the Adriatic-Ionian Area'                                                | BE                  |
| 9  | Agaraj<br>Xhiliola (Shehu)EnidaPulaj,<br>SonilaBerdo,<br>Klaudja Guga,<br>Filloreta Madani,<br>Migena Petanaj.                                                   | Departamenti i Biznesit | Aplikim ne kuadër të thirrje Interreg IPA South Adriatic 2021-2027 me projekt propozimin me titull "Italy_Albania_Montenegro Community Based Tourism" akronim"IAMCBT" | BE                  |
| 10 | Elenica Pjero                                                                                                                                                    | Departamenti i Biznesit | 'Sustainable University - Enterprise Cooperation for ImprovingGraduate Employability'                                                                                 | BE                  |
| 11 | Elenica Pjero                                                                                                                                                    | Departamenti i Biznesit | Erasmus+ KA107                                                                                                                                                        | BE                  |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                                                                                           |                         |                                                                                                                                                                                               |                                                                                                              |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    | Fakulteti per Turizmin dhe Zhvillimin Rural, Pozega, Kroaci                               |                         |                                                                                                                                                                                               |                                                                                                              |
| 12 | Elenica Pjero Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Gjermani                             | Departamenti i Biznesit | Erasmus+ KA107                                                                                                                                                                                | BE                                                                                                           |
| 13 | Elenica Pjero Universiteti i St. Cyril and St. Methodius, Bullgari                        | Departamenti i Biznesit | Erasmus+ KA107                                                                                                                                                                                | BE                                                                                                           |
| 14 | Dr Lorena Serjanaj<br>Prof/ass Dr Rezarta Lalo,<br>Dr. Jonida Mehmetaj, Dr Lorena Cakerri | DKSH                    | Using art therapy and Vitamin D for the prevention of cognitive decline of Alzheimer's disease dementia                                                                                       | European Union's Horizon 2020 Research and Innovation Framework programme under grant agreement No 101007990 |
| 15 | Prof. Asoc. Enkelejd Mehilli                                                              | DKSH                    | CHILDREN_FIRST                                                                                                                                                                                | European Union HORIZON-MSCA-2023-DN-01. HORIZON-TMA-MSCA-DN                                                  |
| 16 | Prof. Asoc. Enkelejd Mehilli                                                              | DKSH                    | EB-STEAM                                                                                                                                                                                      | ERASMUS+ KA2 Capacity Building. European Union.                                                              |
| 17 | PhD Juljana Xhindoli                                                                      | DKSH                    | <i>European Research Network on uses of Ozone in Health Acronym: EuReNet-OzonHE.</i>                                                                                                          | OC-2023-1-26701 COST Association AISBL Brussels, Belgium,                                                    |
| 18 | PhD Juljana Xhindoli                                                                      | DKSH                    | Investigation of mental health problems and levels of mental resilience through a quantitative online study in the student population of the Universities (Ismail Qemali University of Vlora) | Interreg VI-A IPA CBC Programme "Greece-Albania 2021-2027"                                                   |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                         |                       |                                                                                                                                 |                       |
|----|-------------------------|-----------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|
|    |                         |                       | and Eqrem Çabej University of Gjirokastrë in Albania, as well as the University of Ioannina and the Ionian University in Greece |                       |
| 19 | PhD/c Emirjona Kicaj    | DKSH                  | Enhancing practical nursing education in Western Balkans through harmonization with the German system                           | ERASMUS-EDU-2024-CBHE |
| 20 | PhD/c Emirjona Kicaj    | DKSH                  | Impakti i edukimit shëndetësor në përmirësimin e praktikave vet-menaxhuese dhe cilësinë e kujdesjeve për pacientët diabetikë    | Fondi i UV            |
| 21 | PhD/c Rudina Cercizaj   | DKSH                  | "Ndikimi i shpërthimit të COVID-19 në shëndetin mendor të infermierëve, një çështje në zhvillim dhe sfidë e Shëndetit Publik    | Fondi i UV            |
| 22 | Phd.(c) Sonila Nika     | Fakulteti i Shëndetit | Ndikimi i mirëqenies socio-emocionale të pacientit në respektimin e planit të kujdesit infermieror.                             | AKKSHI                |
| 23 | Phd.(c) Vasilika Prifti | Fakulteti i Shëndetit | "Draining Brilliance: Understanding the Exodus of                                                                               | AKKSHI                |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|    |                          |      |                                                                                                                                                                 |            |
|----|--------------------------|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
|    |                          |      | Healthcare Professionals"                                                                                                                                       |            |
| 24 | Msc, PhD (c) Jerina Jaho | QKSH | "Seroprevalenca e infeksionit nga virusi i hepatitit B dhe situata e mbulimit vaksinal te studentët e Fakultetit të Shëndetit, Universiteti i Vlorës, Shqipëri" | Fondi i UV |
| 25 | Brunilda Subashi         | QKSH | "Gjetja e metodës më efektive për përmirësimin e aderencës medikamentoze tek të moshuarit me sëmundje kronike të shumëfishta-studim eksperimental"              | Fondi i UV |
| 26 | Irimi Rapushi            | QKSH | "Korrelacioni ndërmjet keqpërdorimit të antibiotikëve dhe efekteve të padëshiruara të mundshme"                                                                 | Fondi i UV |
| 27 | Fatjona Kamberi          | QKSH | "Përmirësimi i Vlerësimit dhe Menaxhimit të Dhimbjeve Kronike Jo-Onkologjike në Shërbimin Shëndetësor Parësor                                                   | AKKSHI     |
| 28 | Eliona Lici              | FSHH | Studimi i ndikimit të Edukimit muzikor në Pedagogjinë e                                                                                                         | AKKSHI     |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|  |  |  |                                                   |  |
|--|--|--|---------------------------------------------------|--|
|  |  |  | specializuar-Një<br>qasje kërkimore e<br>aplikuar |  |
|--|--|--|---------------------------------------------------|--|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**ii) Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor mbi mësimdhënien.**

Ky informacion paraqitet në mënyre përshkuese, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë: a. Përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në aktivitetin e kërkimit shkencor  
b. Ndikimi i kërkimit shkencor në përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit e kurrikulave mësimore.

Integrimi i kërkimit shkencor në mësimdhënie është një aspekt kyç për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. Universiteti i Vlorës (UV) ka ndjekur një strategji gjithëpërfshirëse për të ndërlidhur këto dy komponentë, duke garantuar që mësimdhënien të reflektojë zhvillimet më të fundit shkencore. Ky raport përmbledh qasjet kryesore, rezultatet dhe praktikën që janë ndjekur gjatë vitit akademik 2023-2024, duke nënvizuar rëndësinë e këtij integrimi për përgatitjen e studentëve dhe zhvillimin e stafit akademik.

Qasjet kryesore në integrimin e kërkimit shkencor në mësimdhënie:

*Përditësimi i materialeve mësimore:* Leksionet janë pasuruar me shembuj konkretë nga tregu lokal, kombëtar dhe global, duke reflektuar rezultatet më të fundit të kërkimit shkencor.

*Angazhimi i studentëve në aktivitete kërkimore:* Studentët janë përfshirë në projekte të lëndës, detyra kursi dhe raste studimore që lidhen me realitetin shqiptar dhe ndërkombëtar. Angazhimi i tyre në aktivitete kërkimore dhe konferenca studentore ka nxitur zhvillimin e aftësive shkencore.

*Pjesëmarrja e personelit akademik në kërkim:* Pedagogët e UV marrin pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca shkencore dhe botime në revista me faktor të lartë impakti.

*Përdorimi i teknikave bashkëkohore:* Literatura dhe teknikat bashkëkohore, interaktive dhe të bazuara në kërkime janë integruar në procesin mësimor.

*Bashkëpunimi ndërkombëtar:* Përmes programeve si Erasmus+ KA1, UV ka forcuar shkëmbimet ndërkombëtare, duke sjellë përvoja të reja në mësimdhënie dhe kërkim.

Rezultatet e arritura:

*Rritja e cilësisë së mësimdhënies:* Aktivitetet kërkimore të stafit kanë ndikuar në rritjen e standardeve akademike, përfshirë marrjen e gradave dhe titujve shkencorë.

*Përfshirja e studentëve në kërkim:* Studentët kanë kontribuar në projekte të financuara nga UV dhe kanë marrë pjesë aktive në konferenca dhe aktivitete promicionale, si Konferenca e Dytë Studentore.

*Zhvillimi i bashkëpunimeve me sektorin privat dhe publik:* Fakultetet kanë ndërtuar marrëdhënie të forta për realizimin e praktikave mësimore dhe projekteve të përbashkëta për studentët.

*Monitorimi i cilësisë në mësimdhënie:* Pyetësorët e vlerësimit nga studentët janë përdorur për të adresuar sfidat dhe për të përmirësuar procesin mësimor.

Universiteti i Vlorës ka realizuar një progres të rëndësishëm në lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, duke krijuar një mjedis ku studentët dhe stafi akademik përfitojnë një përvojë të pasur dhe të integruar. Ky proces ka ndihmuar në përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës dhe ka forcuar cilësinë e përgjithshme të arsimit të lartë. UV mbetet i angazhuar për të thelluar këtë integrim, duke siguruar që kërkimi shkencor të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të tij arsimor dhe shkencor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**iii) Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;**

Ky informacion paraqitet në mënyre përshkruese dhe tabelare duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

- Produktet e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara;
- Të përcaktohet për secilin produkt nëse veprimtaria është organizuar brenda vendit apo jashtë tij;
- Të përcaktohet për secilin produkt niveli i institucionit bashkëpunues nëse është në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar;
- Të paraqiten të dhëna të plota mbi datën, vendin, dhe pjesëmarrësit e angazhuar në kërkim shkencor.

*Produktet e Kërkimit Shkencor 2023-2024*

Universiteti i Vlorës ka treguar një angazhim të veçantë në zhvillimin e kërkimit shkencor gjatë vitin akademik 2023-2024. Aktivitetet kërkimore të stafit akademik dhe studentëve kanë sjellë rezultate të prekshme në forma të ndryshme, përfshirë botime shkencore, projekte kërkimore dhe organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare

*Artikuj shkencor:* Botimi i artikujve shkencorë në revista me faktor impakti ka qënë një prioritet kryesor. Gjatë këtij viti akademik, janë publikuar artikuj në revista ndërkombëtare dhe kombëtare, të cilat mbulojnë fusha të ndryshme shkencore.

*Projektet e fituara dhe implementuara:* Gjatë vitit 2023-2024, janë realizuar projekte shkencore, nga të cilat disa janë financuar nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto projekte kanë kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve të stafit dhe në rritjen e ndikimit shkencor të institucionit.

*Pjesëmarrje në konferenca shkencore:* Personeli akademik ka marrë pjesë aktivisht në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, duke prezantuar punime shkencore të cilat janë vlerësuar për cilësinë dhe relevancën e tyre.

*Botimi i teksteve, cikleve të leksioneve dhe monografive:* Janë botuar tekste universitare, cikle leksionesh dhe monografi, të cilat janë përdorur si materiale mësimore dhe kanë kontribuar në avancimin e dijeve në fushat përkatëse.

*Organizimi i konferencave shkencore dhe aktiviteteve promovuese:* Gjatë vitit akademik, Universiteti i Vlorës ka organizuar konferenca shkencore dhe simpoziume me pjesëmarrje të gjerë nga komuniteti shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Është zhvilluar gjithashtu "Dita Promocionale e Shëndetit," duke sjellë në vëmendje tema të rëndësishme të lidhura me shëndetin publik.

*Angazhimi i stafit në trajnime dhe aktivitete zhvilluese:* Personeli akademik ka marrë pjesë në trajnime, seminare, workshope dhe shkolla verore të organizuara nga projekte të ndryshme, duke rritur ndjeshëm kapacitetet e tyre në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

*Bashkëpunime:* Gjatë periudhës raportuese, janë zhvilluar bashkëpunime me institucione vendase dhe ndërkombëtare, duke krijuar mundësi për shkëmbime akademike dhe kërkimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ka demonstruar përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj zhvillimit të kërkimit shkencor dhe integritetit të tij në shërbim të shoqërisë. Produktet e kërkimit shkencor të arritura gjatë vitit 2023-2024 pasqyrojnë jo vetëm përkushtimin e stafit dhe studentëve, por edhe ndikimin pozitiv të universitetit në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

**Tabela nr. 5: Mbi Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara**

| Nr | Aktiviteti Kërkimor Shkencor                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                            | Njësia bazë/Fakulteti                                              | Partnerët                                                                                                                                                                                                                                                                               | Data/Vendi                                                                   | Vlera                                         | Produkti (Proceeding Book, ISBN/ Revistë)  |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|--------------------------------------------|
|    | Konferenca (Kombëtare/Ndërkombëtare)                                                                                                                                                                                                                                                               | Workshop                                                                                                                                                   |                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                                                                              |                                               |                                            |
| 1  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Workshop Ndërkombëtar, në kuadrin e projektit Smart. me fokus trajtimin e specializimit të zgjuar, pronësinë intelektuale dhe të dhënat me burim të hapur. | Departamenti i Biznesit                                            | DOBA Business School, Maribor Slloveni Politekniku i Milanos Universiteti Teknik i Dresdenit, dhe disa universitete te Ballkanit Perëndimor.                                                                                                                                            | Nëntor 2023,                                                                 | Financim EU                                   |                                            |
- Të dhëna mbi kërkesën dhe ofertën e tregut të punës, në lidhje me programet e studimit që ofrohen nga IAL dhe një vlerësim i tyre.

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" është një institucion arsimor i avancuar, që ofron një gamë të gjerë programesh studimi të akredituara, të cilat janë të përshtatura për të përmbushur nevojat e tregut të punës dhe për të kontribuar në zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. Universiteti ka për qëllim promovimin e kualifikimeve ndërkombëtare dhe formimin e liderëve të ardhshëm në fusha të ndryshme, me qëllim që ata të jenë të përgatitur për të përballuar sfidat e një bote gjithnjë e më globalizuar dhe të ndihmojnë në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë.

#### **FAKULTETI I EKONOMISË**

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ofron programe studimi të Ciklit të Parë Bachelor dhe të Ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave për vitin akademik 2023-2024 si më poshtë:

- Dy diploma të ciklit të parë të studimeve bachelor me kohë të plotë,  
Bachelor në "Financë"  
Bachelor në "Kontabilitet"
- Dy diploma të ciklit të dytë të studimeve, master profesional me kohë të plotë  
Master Profesional në "Financë"  
Master Profesional në "Kontabilitet"
- Dy diploma të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave  
Master Shkencor në "Financë"  
Master Shkencor në "Pasuritë e Paluajtshme"

Departamenti i Ekonomiksit ofron tre programe studimi (aktive):

- Bachelor në "Ekonomiks"  
Master i Profesional "Ekonomiks në Sipërmarrje"  
Master i Shkencave në "Ekonomiks"  
Departamenti i Biznesit ofron këto programe studimi:  
Bachelor në "Administrim Biznesi"  
Bachelor në "Manaxhim Turizem"  
Bachelor në "Marketing"  
Master i Shkencave në "Administrim Publik"  
Master Profesional në "Marketing"  
Master Profesional në "Sipërmarrje në Turizëm"  
Master Shkencor në "Administrim Biznesi"  
Programet e reja të miratuara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Master i Shkencave në "Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve Turistike dhe Kulturore", në bashkëpunim me Universitetin e Studimeve të Barit, Itali ka filluar në vitin 2022-2023.

Master i Shkencave në "Administrim Publik", fillon në vitin 2024-2025

### *Programet e reja të aplikuara*

Master i Shkencave në "Marketing Dixhital"

Programet e përbashkëta të studimit

Është miratuar hapja e programit të dyfishtë të studimit Master Shkencor në "Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve Turistike dhe Kulturore", në bashkëpunim me Universitetin e Studimeve të Barit, Itali.

### *Përshtatshmëria e programeve me misionin e institucionit*

1. *Nderkombëtarizimi:* Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit të ofruara UV, Departamenti i Biznesit Departamenti i Biznesit ka realizuar hapjen ofrimit të programit të dyfishtë të studimit, Master Shkencor në "Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve Turistike dhe Kulturore", me Universitetin e Barit, Itali.
2. *SMART Universitet:* Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e ndërkombëtarizimit UV, Departamenti i Biznesit përveç të tjerash ka krijuar laboratorare mbështetëse si:  
Qendrës së Ndërkombëtarizimit, financim nga MAS  
Qendra Smart City Hub, me Vendim Senati integruar në strukturën e Departamentit të Biznesit
3. *Lider Profesional:* Universiteti synon të shndërohet në një institucion lider përsa i takon formimit profesional në përputhje me standardet Europiane ESCO - Standardi Europian i Kualifikimit të Kompetencave/Aftësive profesionale dhe punësimit që përcaktojnë qartësisht Setin e Kompetencave Profesionale dhe atyre Interpersonale që duhet të fitojnë të diplomuarit. Në plotësimin e këtyre standardeve Departamenti i Biznesit ka rishikuar programet e studimit për t'i përshtatur me kërkesat e tregut të punës në kontekstin Europian, rishikimin dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies bazuar në krijimin e kompetencave profesionale përmes përdorimit të metodave interaktive që nxisin kreativitetin dhe të menduarin kritik dhe jo thjesht dhënien e njohurive të bazuara në tekste.

## **FAKULTETI I SHËNDETIT**

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor ofron programet e mëposhtme:

Bachelor në "Infermieri Mami"

Master Profesional në "Infermieri Pediatrike"

DKSH ka rinisur përsëri kërkesën drejt MASR për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit" si dhe është duke punuar për riorganizimin e Programit Infermieri Mami, ndryshime të cilat bëhen në zbatim të VKM-së nr. 823, Datë 28.12.2023 për "Disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin nr. 41, Datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Gjithashtu, duke iu përmbajtur ndryshimeve inovative të profesionit si dhe nevojave të tregut të punës, stafi i DKSH është duke punuar për të aplikuar për Programin Bachelor në "Teknik Laboratori" dhe programet profesionale 2 vjecare "Asistent Dentar" dhe "Asistencë në Moshat Pediatrike".

Së bashku me disa fakultete të kujdesit shëndetësor që pregatisin infermier dhe mami të ardhshëm në Shqipëri, Departamenti i Kujdesit Shëndetësor në Fakultetin e Shëndetit, Universiteti "Ismael Qemali"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK**

diplomoni cdo vit pothuajse 80 Infermierë Mami të cilët për të ushtruar profesionin duhet të nënshtrohen praktikës së UIISH dhe provimit praktik dhe teorik. Aktualisht, në vit të parë të programit Bachelor Infermieri Mami janë të regjistruar 80 studentë në vit të parë, dhe të diplomuar në Korrik 2023 dhe Shtator janë 60 studentë.

Sipas informacioneve zyrtare të marra nga UIISH, në lidhje me kalueshmërinë e studentëve të Fakultetit të Shëndetit këto 2 vitet e fundit kemi një kalueshmëri me 89% në provimin e praktikës dhe 53 % në provimin e teorisë.

Në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2023 sipas raportit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë punësuar 950 infermierë dhe mami në sistemin shëndetësor publik përmes platformës "Infermierë për Shqipërinë"

Për sa i përket punësimit në institucionet shëndetësore publike, studentët e diplomuar në programin Infermieri Mami i nënshtrohen portalit Infermierë për Shqipërinë. Sipas të dhënave më të fundit të siguruar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të DROKSH Vlorë mbi strukturën plan-fakt për Spitalin Rajonal Vlorë konfirmojnë se janë 19 vende të planifikuara në shërbimin e obstetrikës dhe 6 vende të planifikuara në shërbimin gjinekologjik.

Një burim tjetër i të dhënave mbi punësimin e studentëve të diplomuar nga FSH janë të dhënat e sekretarisë së FSH. Nga të dhënat e sekretarisë së Fakultetit të Shëndetit gjatë vitit 2023 janë tërhequr mbi 80 programe nga studentë të diplomuar nga FSH (Mami dhe Infermierë të përgjithshëm) për kontrata punë kryesisht në shtetin Gjerman, Shtetet e Bashkuara, Itali, Kanada dhe Mbretëria e Bashkuar.

Përveç kësaj në Universitet gjendet dhe zyra e alumnit nga të cilat dalin të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve nga universiteti Ismail Qemali ndër vite. Aktualisht jemi në pritje për të dhënat e përditësuara nga kjo zyrë.

Marrëveshje/ kërkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësim eventuale të studentëve pas diplomimit.

Marrëveshje midis FSH dhe Spitalit Rajonal Vlorë Nr.68, dt.07-10-2015

Marrëveshje midis FSH dhe Spitalit Rajonal Fier Nr.221, dt.10-10-2017

Marrëveshje midis UV dhe Bashkisë Vlorë Nr.775/5, dt.17-06-2019.

Marrëveshje midis UV dhe Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Vlorë Nr.775/3, dt.17-06-2019

Marrëveshje midis UV dhe Artigum Management Albania Nr.813/1, dt.26-05-2020

Departamenti i Infermierisë ofron këto programe studimi:

Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme"

Master Profesional në "Infermieri Patologjike"

Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"

Master Shkencor në "Shkenca Infermiore"

Këto programe formojnë specialist të shërbimeve shëndetësore, çka përputhet me misionin e departamentit tonë, por edhe të fakultetit, për të operuar në fushën e shërbimeve të shëndetit, për të cilat sot ka një nevojë të madhe në tregun e punës.

*Përshtatshmëria e programeve me misionin e institucionit*

Të gjithë programet e FSH formojnë specialistë të shërbimeve shëndetësore, çka përputhet me misionin e fakultetit për të operuar në fushën e shërbimeve të shëndetit, për të cilat sot ka një nevojë të madhe në tregun e punës.

*Studimi i tregut të punës*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK**

Në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2023 sipas raportit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë punësuar 950 infermierë në sistemin shëndetësor publik përmes platformës "Infermierë për Shqipërinë"

Sipas faqes zyrtare të agjencisë së punësimit Dekra, rreth 2260 infermiere janë punësuar në këto kompani në shtetin Gjerman

Profesioni infermior vazhdon të jetë një prej profesioneve më të nevojshme dhe më të kërkuar në shëndetësi. Popullata e shumë vendeve të zhvilluara vazhdon të plakët dhe sipas OBSH 1/4 e popullsisë deri në vitet 2030 do të kenë nevojë të vazhdueshme për kujdes shëndetësor sepse numri i popullsisë mbi 60 vjeç do të shkojë nga 12% në 22%. Sipas Këshillit Ndërkombëtar të Infermierisë, për shkak të numrit të ulët të infermierëve, daljet në pension dhe rritjet e efekteve të Covid 19 është përlogaritur që në të ardhmen e afërt do të duhen 13 milionë infermierë për të mbushur këtë boshllëk në profesion. Shkollat profesionale, kolegjet dhe universitetet vazhdojnë të nxjerrin breza profesionistësh por do të duhen 3-4 vjet diferencë për të mbushur boshllëkun e krijuar për profesionistë shëndetësorë. Së bashku me disa fakultete të kujdesit shëndetësor që përgatisin infermierë të ardhshëm në Shqipëri, Fakulteti i Shëndetit në Universitetin Ismail Qemali diplomon çdo vit pothuajse 250 infermierë të cilët për të ushtruar profesionin duhet të nënshtrohen praktikës së UISH dhe provimit praktik dhe teorik. Aktualisht, në vit të parë të programit Bachelor Infermier i Përgjithshëm, janë të regjistruar 180 studentë në vit të parë dhe të diplomuar në Korrik 2024 janë 114 studentë dhe 46 Shtator

Punësimi në rrethin e Vlorës dhe rajonin përreth:

Numri i personelit infermior në Qarkun e Vlorës (Vlorë, Sarandë, Delvinë, Himarë):

- Shërbimi parësor: 860 vende punë për infermierë (300 qytet / 560 fshat)
- Shërbimi dytësor: 396 vende punë për infermierë.

Sipas informacioneve zyrtare nga UISH në Rrethin e Vlorës janë 400 infermierë vetëm në qendrat shëndetësore, nga të cilët 200 janë të diplomuar nga FSH dhe në spitalin rajonal të Vlorës janë të punësuar gjithsej 286 infermierë nga të cilët 120 të diplomuar nga FSHP. Kurse në Spitalin Psikiatrik janë të punësuar gjithsej 35 infermierë nga të cilët 24 të diplomuar nga FSH.

Për provimin e aftësive të praktikës në vitin 2023, nga Fakulteti i Shëndetit, Universiteti Ismail Qemali, u testuan 155 studentë të Infermierisë së Përgjithshme, nga të cilët 139 rezultuan kalues, dhe 16 jo kalues, pra me një kalueshmëri 87%. Ndërsa në provimin teorik, nga Fakulteti i Shëndetit u testuan 207 diplomantë, nga të cilët kaluan provimin 158 individë, pra një kalueshmëri me 76%. kaluan provimin 158 individë, pra një kalueshmëri me 76%.

Sipas portalit Infermierë për Shqipërinë, duke filluar që nga muaji Shkurt 2024 deri në Tetor 2024, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e punësimit të infermierëve në 4 qarqet e Shqipërisë, Tiranë, Vlorë, SHkodër dhe Elbasan ku përfshihen të dhëna për punësimin në shërbimet parësore dhe spitalore.

Ndërkohë pas portalit sipas Operatorit të Shëndetit, në listë pritjeje për vende definitivë që i janë nënshtruar portalit të punësimit janë për rajonin e Tiranës 1713 individë, Vlorë 508 dhe Elbasani rreth 740 infermierë të rinj, Shkodër 350 infermierë.

Një burim tjetër i të dhënave mbi punësimin e infermierëve të diplomuar nga FSH janë të dhënat e sekretarisë së FSH.

Nga të dhënat e sekretarisë së Fakultetit të Shëndetit gjatë vitit 2023 -2024 janë tërhequr mbi 140 programe nga studentë të diplomuar nga FSH (Mami dhe Infermierë të përgjithshëm) për kontrata punë kryesisht në shtetin Gjerman, Shtetet e Bashkuara, Itali, Kanada dhe Mbretëria e Bashkuar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

### FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

*Programet e studimit aktive që ofron Fakulteti*

Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, ofron këto programe aktive studimi në shtatë departamentet e tij:

“Akuakulturë dhe produkte të peshkimit”

“Teknik laborator kimik”

Bachelor në “Biologji”

Bachelor në “Inxhinieri Navale”

Bachelor në “Inxhinieri Mekanike”

Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”

Bachelor në “Navigacion”

Bachelor në “Matematikë”

Bachelor në “Matematike-Fizike”

Bachelor në “Teknologji Informacioni”

Bachelor në “Informatikë”

Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”

Bachelor në “Kimi”

MP në “Operacione Industriale dhe Navale”

MP në “Studime të Avancuara Detare”

MP në “Mësuesi në MP Arsimin e Mesëm në Biologji me profil minor në kimi”

MP në “Mësuesi në Arsimin e Mesëm në lëndën Matematikë”

MP në “Mësuesi në Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë”

Master i Shkencave në “Mësuesi në AML në Kimi”

Master i Shkencave në “Biologji Mjedisore”

Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”

*Përshtatshmëria e programeve me misionin e institucionit*

*Programet e studimit në FSHTN janë të kërkuara në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit. Studentët diplomuar të Inxhinjerive, shkencave detare dhe kompjuterike nga gjurmimi i berë konstatohet se pothuajse janë të ingranuar në tregun e punës.*

Gjithashtu nga strukturat përkatëse janë bërë përmirësimet e rekomanduara gjatë implementimit të projekteve të përbashkëta, me qëllim mundësimin e mobilitetit të studentëve, por mbi të gjitha njihen e ketyre diplomave në tregun rajonal të punës

### FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Departamenti i Gjuhë-Letërsisë është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane që zhvillon veprimtari mësimdhënëse dhe kërkimore-shkencore në fusha ku përfshihet mësimdhënie në gjuhë shqipe dhe letërsi, albanologji dhe komunikim.

Programet e ushtruara nga gupi mësimdhënës në departament janë:

Bachelor në “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”

Bachelor në “Media, Komunikim dhe Trashëgimi Kulturor me profilet: Gazetari dhe Multimedia, Trashëgimi Kulturor”





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Master i Shkencave në "Mësimdhënien e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë".

Vitin akademik 2021-2022 departamenti do ta nis edhe me programin *Bachelor ne Media, Komunikim dhe Trashegimi kulturore*, hapur me Urdher ministri, date, nr. 249, 29.09.2021

Departamenti synon të formojë dhe të përgatisë, studentë premtues, profesionistë cilësorë në përshtatje me kërkesat e tregut të punës, jo vetëm në nivel rajonal por edhe më gjerë, duke kaluar çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike apo kulturore. Të mbështesë zhvillimin e vlerave më të larta njerëzore, duke ofruar shërbime cilësore akademike dhe të integruara jo vetëm në rajonin e Vlorës por në të gjithë Shqipërinë.

Misioni i Departamentit bazohet në:

Mësimdhënie bashkëkohore sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.

Punë kërkimore bazë dhe të aplikuar.

Punë akademike të cilësisë së lartë në përputhje me standardet evropiane ESCO të Komunitetit Evropian.

Shërbime të efektshme dhe ndikuese në publik dhe në komunitet, programe gjithëpërfshirëse aktiviteteve për zhvillimin e studentëve dhe rolit të tyre në ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit lokal.

Aplikimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërveprimin me studentët në fushën e shërbimeve dhe mësimdhënies.

Promovim i kërkimit shkencor dhe aplikim i rezultateve të kërkimit tek të tretët.

Ofrimi i një formimi të plotë akademik në të gjitha ciklet e studimit.

Ofrimi i programeve të edukimit të vazhduar me qëllim për t'a lidhur departamentin me tregun.

Të sigurojë një impakt të rëndësishëm në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin social të qytetit të Vlorës dhe më gjerë.

Të mundësojë aplikimin e teknologjisë informative në shërbime ndaj studentëve dhe për studentët. Gjatë vitit 2023-2024 Departamenti i Drejtësisë, ka përmbyllur me cilësi misionin e tij, në bazë të ligjit për arsimin e lartë, për të dhënë një edukim me standarde të larta bashkëkohore për studentët e drejtësisë. Veprimtaria e Departamentit të Drejtësisë është mbështetur si në mësimdhënien cilësore ashtu edhe në kërkimin shkencor.

Mësimdhënia në Departamentin e Drejtësisë është organizuar në formën e mësimin në auditor, në leksione dhe në seminare, mësimin jashtë auditorit, të organizuar në formën e mësimin individual dhe të praktikave mësimore. Në planin Strategjik të Departamentit të Drejtësisë, për vitet 2018- 2024 mësimdhënia bashkëkohore është përcaktuar si një ndër misionet më të rëndësishme në mësimdhënie, kjo është arritur

përmes ofrimit të programeve bashkëkohore të studimit, përmendim këtu hartimin dhe implementimin e programit 5-vjecar në Drejtësi, në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë. Implementimi i këtij programi ka rritur cilësinë e diplomës së ofruar, e pasqyruar edhe kjo në Kornizën Kombëtare të Kualifikimit, duke kaluar nga diplomë e ciklit të parë të studimeve në diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi.

Me qëllim realizimin e programit 5-vjecar Departamenti i Drejtësisë, ka rritur kapacitetet e veta, ku një pjesë e stafit të tij kanë avancuar në karrierën e tyre akademike duke marrë titujt Profesor i Asociuar dhe duke sjell një rritje të mtejshme edhe në nivelin e mësimdhënies. Aktualisht i gjithë stafi akademik i brendshëm i Departamentit të Drejtësisë mban titullin Doktor Shkencash dhe dy prej tyre titullin Profesor i Asociuar.

Krahas programit 5-vjecar Master i Shkencave në Drejtësi, Departamenti i Drejtësisë ofron edhe tre programe të ciklit të dytë të studimeve si Master Profesional në "E drejtë Penale", Master Profesional



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK**

në "E Drejtë Administrative" dhe Master Shkencor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" duke krijuar mundësi për studime më të thelluara në fushat përkatëse. Të gjitha kurrikulat e ofruara janë bashkëkohore dhe të unifikuara edhe me ato të universiteteve të tjera duke bërë më të lehtë mundësinë e transferimit të krediteve nga një universitet në tjetrin. Kurset e ofruara në të gjitha programet e studimit japin informacionin e nevojshëm për të përgatitur student të aftë për tregun si dhe programet e cdo lënde janë në përputhje me kërkesat e VKM-së. Një ndër synimet e mësimdhënies në Departamentin e Drejtësisë ka qënë edhe rritja e fleksibilitetit të pedagogëve të këtij Departamenti në ofrimin e kurseve për student të huaj.

Me qëllim aftësimin me njohuri praktike studentëve, Departamenti i Drejtësisë ka aktive disa marrëveshje me institucione të ndryshme për realizimin e praktikave mësimore për studentët e programeve Master Profesional dhe Master Shkencor. Po ashtu studentët e vitit të fundit të Masterit Shkencor janë mbështetur, përmes udhëheqjes në realizimin e temave të tyre të diplomimit, kurse studentët e Masterit Profesional janë mbështetur në përgatitjen e tyre për provimin final.

*Departamenti i Gjuhëve të Huaja ofron këto programe:*

*Bachelor në "Gjuhë angleze"*

*Bachelor në "Gjuhë italiane"*

*Master profesional në "Mësuesi për CLAB në lëndën gjuhe angleze"*

*Master profesional në "Mësuesi për CLAB në lëndën gjuhe italiane"*

*Master i shkencave në "Perkthim dhe interpretim"*

*Departamenti i Edukimit gjatë 2023-2024 ka zhvilluar këto programe:*

*Bachelor në "Histori-gjeografi"*

*Bachelor në "Mësuesi për arsimin parashkollor"*

*Bachelor në "Mësuesi për arsimin fillor"*

*Bachelor në "Pedagogji e specializuar sociale"*

*Master profesional në "Mësuesi për arsimin fillor KL I-IV"*

*Master i shkencave në "Edukim"*

*Master i shkencave në "Pedagogjinë e specializuar sociale"*

*8. Master profesional në "Mësuesi për histori-gjeografi"*

*Program formimi në Psiko-Pedagogji*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**e) Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.**

Ky informacion paraqitet në mënyre përshkruese, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

- Të dhëna në lidhje me ndryshimet në aktet e brendshme të IAL-së, si rregulloret, kodet e etikës statutet e IAL-së ose të Fakulteteve, duke parshtruar ndryshimet e bëra (nëse ka).
- Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas tabelës mëposhtë:

Në kuadër të vitit akademik 2023-2024, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka realizuar disa ndryshime në aktet e brendshme, përfshirë rregulloret, kodin e etikës dhe statutin. Këto ndryshime janë miratuar nga Senati Akademik dhe janë implementuar në përputhje me rekomandimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS), me qëllim përmirësimin e proceseve administrative dhe akademike. Më poshtë paraqiten ndryshimet të miratuara:

Me vendim të Senatit Akademik nr. 57, datë 21.11.2023 është miratuar "Rregullore e programit të studimeve të integruara të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave" në drejtesi.

Me vendim të Senatit Akademik nr. 19, datë 23.04.2024 është miratuar "Për një saktësim në nenin 3 të Rregullore së zgjedhjeve dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Me vendim të Senatit Akademik nr.36, datë 23.09.2024 është miratuar Rregullorja për akordimin e Titullit akademik "Profesor Emeritus".

Me vendim të Senatit Akademik nr. 9, datë 06.03.2024 është miratuar "Rregullore e proqatimit të studimit "Master i Shkencave në Administrim Publik".

Me vendim të Senatit Akademik nr.11, datë 21.03.2023 është miratuar Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Me vendim të Senatit Akademik nr. 18, datë 18.04.2024 është miratuar ndryshimi i nenit 10 në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Me vendim nr.25, datë 17.05.2024 Senati Akademik ka miratuar "Për disa saktësime në Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Me vendim nr. 27, datë 26.07.2024 Senati Akademik ka miratuar "Për një ndryshim në nenin 10 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Me vendim nr. 39, datë 23.09.2024 Senati Akademik ka miratuar "Për disa saktësime në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve dhe organeve drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për zhvillimin, monitorimin dhe përmirësimin e standardeve të cilësisë. Ajo siguron që shërbimet të plotësojnë kërkesat dhe standardet e përcaktuara, duke përmirësuar vazhdimisht proceset e punës dhe duke ruajtur përputhshmërinë me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare. Veprimtaria e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë përfshin një seri veprimtarish dhe procese që synojnë të sigurojnë dhe përmirësojnë cilësinë e arsimit dhe shërbimeve në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë. Aktivitetet e përfshira janë të fokusuara kryesisht në akreditimin dhe vlerësimin e programeve të studimit, përfshirë Bachelor, Master, Diplomë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Profesionale si dhe mbështetje në zhvillimin e programeve akademike dhe shërbimeve administrative. Këto veprimtari janë pjesë e një procesi të vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë akademike dhe administrative, duke përfshirë akreditimet e programeve, vlerësimet e mësimdhënies, dhe vlerësimin e shërbimeve që ofrohen për studentët.

**Tabela nr. 8: Mbi veprimtarinë e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë**

| Nr. | Aktiviteti/Veprimtaria                                                                                  | GVB/Përbërja                                                                                                                               | Periudha kohore | Rezultati/prodkti                                                   |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|---------------------------------------------------------------------|
| 1.  | <b>Akreditim</b><br>Diplomë Profesionale:<br>"Teknik Laboratori"                                        | Prof.As.Flora Qarri<br>Dr.Marinel Muco<br>Dr.Areta Alinj<br>Dr.Jonida Salihila<br>Dr.Anisa Myrtaj<br>Antonela Qarri                        | 2023-2024       | (Paguar)<br>Në proces                                               |
| 2.  | <b>Akreditim</b><br>Diplomë Profesionale :<br>"Akuakulturë dhe<br>Higjenë e produkteve të<br>peshkimit" | Dr. Aurora Bakaj<br>Prof. Asoc. Bledar Pepa<br>PhD. Ina Nasto<br>Dr. Matilda Shehu<br>Ermelinda Alliaj<br>Anxhela Kamberaj                 | 2023-2024       | (Paguar)<br>Në proces                                               |
| 3.  | <b>Akreditim</b><br>Diplomë Profesionale:<br>"Udhërrëfyes turistik për<br>Rajonin e Jugut"              | NJSBCVI<br>Njesi Baze                                                                                                                      | 2023-2024       | Akreditim për herë<br>të parë<br>Në proces                          |
| 4.  | <b>Akreditim</b><br>Master Profesional –<br>"Histori-Gjeografi"                                         | Prof.as.Aleks Trushaj<br>Phd.Esmeralda Laci<br>Dr.Ilira Llupa<br>Dr.Elsajed Rexhaj<br>Dr.Blerina Xhelaj<br>Sidorela Rapushaj<br>Joana Lapa | 2023-2024       | (Paguar)<br>Në proces                                               |
| 5.  | <b>Akreditim</b><br>Master Shkencor:<br>"Shkenca Kompjuterike"                                          | NNJSBCVI<br>Njesi Baze                                                                                                                     | 2023-2024       | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 6.  | <b>Akreditim</b><br>Master Shkencor:<br>"Biologji Mjedisore"                                            | NJSBCVI<br>Njesi Baze                                                                                                                      | 2023-2024       | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 7.  | <b>Akreditim</b><br>Master<br>Shkencor:"Administrim<br>Biznesi"                                         | NJSBCVI<br>Njesi Baze                                                                                                                      | 2023-2024       | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 8.  | <b>Akreditim</b>                                                                                        | NJSBCVI                                                                                                                                    | 2023-2024       | (Pagesë shqyrtimi)                                                  |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|     |                                                                                           |                       |           |                                                                     |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|-----------|---------------------------------------------------------------------|
|     | Master Shkencor:<br>"Financë"                                                             | Njesi Baze            |           | Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë                       |
| 9.  | <b>Akreditim</b><br>Master Shkencor:<br>"Pasuri të Paluajtshme"                           | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 10. | <b>Akreditim</b><br>Master Shkencor:<br>"Ekonomiks"                                       | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 11. | <b>Akreditim</b><br>Master Shkencor:<br>"Shk. Infermierore"                               | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 12. | <b>Akreditim</b><br>Master Shkencor:<br>"Edukim"                                          | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 13. | <b>Akreditim</b><br>Master Shkencor:<br>"Përkthim dhe<br>Interpretim"                     | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 14. | <b>Akreditim</b><br>Master Shkencor:<br>"Pedagogji e<br>Specializuar Sociale"             | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 15. | <b>Akreditim</b><br>Master<br>Shkencor: "Marrëdhënie<br>Ndërkombëtare"                    | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 16. | <b>Akreditim</b><br>Master<br>Shkencor: "Mësimdhënie<br>e Gjuhës Shqipe dhe<br>Letërsisë" | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | (Pagesë shqyrtimi)<br>Në proces<br>Kërkesë për<br>akreditim të parë |
| 17. | <b>Akreditim</b><br>Bachelor:<br>"Histori-Gjeografi"                                      | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | Kërkesë për<br>Riakreditim<br>Fazë shqyrtimi prej<br>ASCAL          |
| 18. | <b>Akreditim</b><br>Bachelor:<br>"Kontabilitet"                                           | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | Kërkesë për<br>Riakreditim<br>Fazë shqyrtimi prej<br>ASCAL          |
| 19. | <b>Akreditim</b><br>Bachelor:                                                             | NJSBCVI<br>Njesi Baze | 2023-2024 | Kërkesë për<br>Riakreditim                                          |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|     |                                                                                                                                                                 |                                                                                         |              |                                                                                                                                                                                                                                  |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|--------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | "Financë"                                                                                                                                                       |                                                                                         |              | Fazë shqyrtimi prej ASCAL                                                                                                                                                                                                        |
| 20. | <b>Akreditim</b><br>Bachelor:<br>"Administrim Biznesi"                                                                                                          | NJSBCVI<br>Njesi Baze                                                                   | 2023-2024    | Kërkesë për<br>Riakreditim<br>Fazë shqyrtimi prej<br>ASCAL                                                                                                                                                                       |
| 21. | <b>Akreditim</b><br>Bachelor:<br>"Marketing"                                                                                                                    | NJSBCVI<br>Njesi Baze                                                                   | 2023-2024    | Kërkesë për<br>Riakreditim<br>Fazë shqyrtimi prej<br>ASCAL                                                                                                                                                                       |
| 22. | <b>Akreditim</b><br>Bachelor:<br>"Manaxhim Turizmi"                                                                                                             | NJSBCVI<br>Njesi Baze                                                                   | 2023-2024    | Kërkesë për<br>Riakreditim<br>Fazë shqyrtimi prej<br>ASCAL                                                                                                                                                                       |
| 17. | <b>Workshop</b><br>Takimi online i ASCAL-it:                                                                                                                    | NNJSBCVI                                                                                | 13.02.2024   | Pjesëmarrja në këtë takim tregon një bashkëpunim të ngushtë me organizatat e tjera arsimore dhe një përkushtim për të adresuar sfidat e përbashkëta në arsimin e lartë, siç është misioni i institucioneve të arsimit të lartë." |
| 18. | <b>Fokus-Grupe</b><br>Bachelor në:<br>"Administrim Biznesi";<br>"Manaxhim Turizmi";<br>"Marketing"                                                              | NJSBCVI<br>Drejtues Departamenti<br>Studentë të programeve të studimit objekt vlerësimi | 12 mars 2024 | Nxjerrja e gjetjeve dhe përcjellja tek strukturat përgjegjëse për përmirësimin e programeve të studimit                                                                                                                          |
| 19. | <b>Fokus-Grupe</b><br>Bachelor në:<br>"Financë";<br>"Kontabilitet";<br><br>Master Shkencor në:<br>"Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve Turistike dhe Kulturore". | NJSCVBI<br>Drejtues Departamenti<br>Studentë të programeve të studimit objekt vlerësimi | 13 mars 2024 | Nxjerrja e gjetjeve dhe përcjellja tek strukturat përgjegjëse për përmirësimin e programeve të studimit                                                                                                                          |
| 20. | <b>Fokus-Grupe</b><br>Bachelor në:                                                                                                                              | NJSBCVI<br>Drejtues Departamenti                                                        | 15 mars 2024 | Nxjerrja e gjetjeve dhe përcjellja tek strukturat                                                                                                                                                                                |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|     |                                                                                                                                                                                                                         |                                                                                               |              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     | Media, Komunikim dhe Trashëgimi Kulturore me dy profile:<br>-"Gazetari dhe Multimedia"<br>-"Trashëgimi Kulturore",<br>-"Histori-Gjeografi";<br>Diplomë Profesionale në:<br>-"Udhërrëfyes Turistik për Rajonin e Jugut". | Student të programeve të studimit objekt vlerësimi                                            |              | përgjegjëse për përmirësimin e programeve të studimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| 21. | <b>Fokus-Grupe</b><br>Diplomë Profesionale në:<br>-"Akuakulturë dhe Higjenë e Produkteve të Peshkimit"<br>-"Teknik Laboratori Kimik".                                                                                   | NJSBCVI<br>Drejtues Departamenti<br>Student të programeve të studimit objekt vlerësimi        | 8 prill 2024 | Nxjerrja e gjetjeve dhe përcjellja tek strukturat përgjegjëse për përmirësimin e programeve të studimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 22. | <b>Pyetësor Alumni</b><br>Urdhër Nr. 64 Rektori                                                                                                                                                                         | NJSBCVI<br><br>SEKTORI I KESHILLIMIT TË KARRIERËS, ALUMNI DHE AKTIVITETEVE KULTURORE-SPORTIVE | 2023-2024    | Rifillimi i procesit të anketimit të Alumni-t për të mbledhur mendimet dhe përvojat e studentëve pas përfundimit të studimeve. Ky proces është i rëndësishëm për të kuptuar më mirë ndikimin e programeve tona dhe për të identifikuar mundësi për përmirësim. Vlerësimi i tyre është thelbësor për zhvillimin e vazhdueshëm të universitetit dhe për të ndihmuar brezat e ardhshëm të studentëve." Ky formulim thekson rëndësinë e |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|     |                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                             |           | kontributit të<br>Alumni-t dhe<br>qëllimin e procesit.                                                                           |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 23. | Pyetësi i Shërbimeve<br>ndihmës akademike dhe<br>administrative<br>(Rekomandime)<br>Urdhër Nr. 125/2023<br>Rektori | Prof.As Frosina Londo<br>(Qyrdeti)<br>Prof.As Enkelejd<br>Mëhilli<br>Prof.As Denada Sota<br>Dr.Amali Çipi<br>Dr.Erjona Dervishaliaj<br>Dr.Rezarta lalo<br>Entela Islamaj<br>Romina Xhelaj<br>Laura Allushaj | 2023-2024 | Nxjerrja e<br>rekomandimeve<br>për përmirësimin e<br>shërbimeve<br>ndihmës<br>akademike dhe<br>administrative ndaj<br>studentëve |
| 24. | Pyetësor i vlerësimit të<br>cilësisë së mësimdhënies<br>(Rekomandime)<br>Urdhër Nr.105/2023<br>Rektori             | Prof.As Enkelejd<br>Mëhilli<br>Prof.As Frosina Londo<br>(Qyrdeti)<br>Dr.Amali Çipi<br>Prof.As Denada Sota<br>Dr. Oljana Hoxhaj<br>Dr. Rezarta Lalo                                                          | 2023-2024 | Nxjerrja e<br>rekomandimeve<br>për përmirësimin e<br>cilësisë së<br>mësimdhënies                                                 |

**f) Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre, për secilin semestër të vitit akademik.**

Gjatë vitit akademik 2023-2024 në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë janë planifikuar për mësimdhënie në 196 staf efektiv dhe 86 staf i ftuar ose me kohë të pjesshme: 82415 orë për stafin efektiv dhe 7341 orë për stafin e ftuar ose me kohë të pjesshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik

| Nr | Emër | Mbiemër | Pozicioni/ titulli/ grada | Mësimdhënia                                            |                                      |          |            |                                             |                                                                                                     |                                     |                          |                               |                         |                               |                                       |                                      | Veprimtari në mbështetje të mësimdhënies                                                               |                                                                                 |                                |                                        | Shuma e orëve vjetore të punës |                                      |
|----|------|---------|---------------------------|--------------------------------------------------------|--------------------------------------|----------|------------|---------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|--------------------------|-------------------------------|-------------------------|-------------------------------|---------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|----------------------------------------|--------------------------------|--------------------------------------|
|    |      |         |                           | Ngarkesa mësimore vjetore sipas Udhëzimit Nr. 29, 2018 | Ngarkesa Mësimore Vjetore në Auditor |          |            |                                             | Veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor, të pagueshme sipas Udhëzimit Nr. 29 |                                     |                          |                               |                         |                               | Totali Ngarkesa vjetore (Mësimdhënie) | Totali Orë Suplementare të Pagueshme | Veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor, jo të pagueshme sipas Udhëzimit Nr. 29 |                                                                                 |                                |                                        |                                |                                      |
|    |      |         |                           |                                                        | Leksione                             | Seminare | Laboratorë | Totali Ngarkesa Mësimore Vjetore në Auditor | Totali Orë Suplementare në Auditor                                                                  | Udhëheqje teze diplome Cikli i I/II | Udhëheqje Teze Doktorate | Drejtim i Praktikave Mësimore | Oponencë Teze doktorate | Pjesëmarrje në juri doktorate |                                       |                                      | Totali Orë Suplementare jashtë Auditorit (të pagueshme)                                                | Veprimtari jashtë auditorit, në mbështetje të procesit mësimor, jo të pagueshme | Veprimtari për kërkim shkencor | Veprimtari për kontribut institucional |                                | Veprimtari për kontribut profesional |
